

## SPECIALE



**BASHA:**  
**GARANTOJMË**  
**ANËTARËSIMIN**  
**E SHQIPËRISË**  
**NË BE**

Faqe 2-3

## INTERVISTA



**BASHA:**PD ka  
resurse për të bërë  
disa lista kandidatësh  
për deputetë, parimi  
kryesor që udhëhoqi  
procesin qenë vlerat

Faqe 4

## VOTO 9



**Votoni**  
**Partinë**  
**Demokratike**  
**për një**  
**Shqipëri të**  
**begatë!**

Faqe 12

# EDMOND ISAKU: SË BASHKU PËR FITOREN E MADHE ME LULZIM BASHËN KRYEMINISTËR-PROJEKSION I SHQIPTARËVE MË VOTONI, DO TË PËRFAQËSOJ INTERESAT TUAJA NË PARLAMENTIN E RI SHQIPAR...

*Të nderuar miq!*

Tashmë që gara elektorale ka startuar, dhe mu a m'u dha besimi nga lidershipi demokrat të jem Nr.4 në listën e kandidatëve të PD në qarkun e Dibrës, shpreh bindjen e palëkundur në mbështetjen tuaj, për të maksimalizuar votën për PD-në dhe për të garantuar **FITOREN TONË TË MADHE**.

Kandidimin tim e konsideroj vlerësim maksimal të kontributit dhe karrierës time gati 30-vjeçare për Partinë Demokratike...

Kam besim të plotë në mbështetjen tuaj dhe të gjithë qytetarëve të Dibrës, Matit, Bulqizës, Maqellarës, Shpenzës e Gjoricës, Ostrenit, Trebishtit e Okshtunit, Zerqanit, Fushë Bulqizës e Martaneshit.

Le të punojmë së bashku, shtëpi më shtëpi, familje më familje e me këdo që dëshiron ndryshimin e shumëkërkuar.

*I juaji*  
**MOND ISAKU**





**Mirëmbërëma Shqipëri!**

**P**ërshëndetje ju motra dhe vëllezër që keni mbushur këtë shesh. Ju motra dhe vëllezër shqiptar kudo që ndodheni në këtë mbrëmje hyjnore të bashkimit tonë për ndryshim me të cilin do të fitojë Shqipëria dhe çdo shqiptar.

Mirëmbërëma kandidatëve të Partisë Demokratike të Shqipërisë, aleatëve tanë të koalicioni, ekipit tonë të fitores dhe ndryshimit për çdo shqiptar. Edhe 31 ditë. Vetëm 31 ditë për të nisur së bashku rrugën e ndryshimit të Shqipërisë, rrugën e zhvillimit, të punësimit, të mirëqenies dhe të integritetit të saj në familjen tonë europiane. Jemi këtu të gjithë bashkë dhe jam mes jush sepse ju keni marrë një vendim shumë të rëndësishëm ti japim së bashku fund tranzicionit shqiptar dhe të hapim një faqe të re të historisë moderne dhe europiane të Shqipërisë. Të mundësojmë që më të mirët, më të ndershit të drejtojnë fatet e vendit sepse familja jonë e madhe Shqipëria ka nevojë sot më shumë se kurrë për punë, nder dhe ndryshim rrënjësorë. Sepse ne sot më shumë se kurrë duhet të mbrojmë e të vendosim në vendin e duhur krenarinë tonë të kahershme kombëtare si shqiptarë, sepse duhet të ndalojmë një orë e më parë këtë varfërim dhe këtë zbrazje që po i ndodh sot Shqipërisë, sepse nënat dhe motrat tona duhet të kursen nga dhimbja që shkakton braktisja e vatrave të familjes, që si pasojë sjell braktisjen e madhe që ka pllakosur sot mbarë vendin, sepse Shqipëria gjithmonë ka qenë kryelartë në shekujt e trazuar të historisë së vet. Dhe ne jemi sot këtu si përgjigje e thirrjes së saj për të ndalur dorën që zhvat pasuritë e kombit, dorën që vret shpresën e shqiptarëve dhe mendjen e errët që kërkon të mbjellë frikën dhe dyshimin në zemrat e bashkatdhetarëve tanë. U bënë më shumë se një vit që filluam këtë marshim, këtë rrugëtim për të ndryshuar vendin tonë. Është një rrugëtim i vështirë por të cilin ne e kryejmë me përgjegjësi dhe me një gëzim të brendshëm sepse ne jemi të vetëdijshëm se puna jonë është një përkushtim dhe sakrificë për vendin, për shqiptarët, për Shqipërinë, për kombin sepse po

shkulum dhe çrrënjësim nga damarët e tokës tonë një kast, një grusht, një të keqe që ka vendosur të shterojë dhe të përvetësojë për interesat e veta të gjitha pasuritë dhe burimet që Zoti kaq bujarisht ia ka falur Shqipërisë. Dhe po luftojmë kundër një grushti njerëzish që janë gati të bëjnë gjithçka vetëm për të mbajtur karriget e tyre por në të vërtetë ata nuk na qeverisin por ju shërbejnë vetes dhe ortakëve të tyre që po rrëmbejnë përmes akteve grabitqare gjithçka që ky vend ka, pasuritë tuaj, pasuritë e kombit. Por vëllezër dhe motra ne po zhvillojmë edhe një betejë tjetër, një betejë brenda vetes. Unë e di se pas 8 vitesh zhgënjime, mashtrime shumëkujt i ka humbur besimi e shumëkush mendon se ky vend nuk ndryshon. Për të gjithë ata që kështu mendojnë unë kam një pyetje për ju. A është kjo ajo që ne meritojmë? A janë varfëria dhe kostoja e jetës që rritet çdo ditë e më shumë ajo që ne meritojmë? A është mungesa e vendeve të punës, papunësia dhe mjerimi ajo që meritojmë? A është largimi nga sytë këmbët i rinisë, i këtij populli të talentuar, ajo që meritojmë? A është ky fati i shkruar për secilin prej nesh? Jo, nuk ka gënjeshtrë më të madhe se kjo. Ky vend meriton më shumë, shqiptarët meritojnë më shumë dhe prandaj ne jemi sot këtu para jush që tua bëjmë të qartë të gjithëve, ne shqiptarët meritojmë më shumë dhe mundemi të bëjmë më shumë dhe do të bëjmë shumë më shumë për njëri-tjetrin dhe për Shqipërinë. Për muaj të tërë ditë pas dite kam shkruar në çdo qytet, në çdo cep, në çdo kënd të Shqipërisë kam ndjerë etjen për ndryshim, kam prekur me duart e mia shpresën, kam marrë përqafimet e ngrohta shpresëdhënëse kudo nga jugu në veri. Kam folur dhe kam shpjeguar se gjërat mund të shkojnë më ndryshe dhe më mirë dhe kam njoftuar në çdo derë dhe familje shqiptare që më ka hapur derën se ndryshimi po vjen, se ndryshimi do ta sjellim, se Shqipëria do të ndryshojë. Kam lexuar në sytë tuaj një nxitje dhe një forcë të papërsëritshme, një frymëzim për të ecur përpara që vetëm një popull i vuajtur por i vendosur për t'i dhënë fund vuajtjes di si ta japë dhe po ju zbuloj sot, çfarë më kanë thënë shqiptarët

anë e kënd Shqipërisë. Jemi gati për një ndryshim të madh por na e hiqni këtë peshë të rëndë që kemi mbi supet. Këta qeveritarë që vetëm na zhvasin, që nuk na zgjidhin asgjë, që pasi kanë zhvatur gjithçka duan të na vrasin dhe shpresën dhe besimin. Dhe ne të gjithë së bashku me 25 prill do t'ja heqim popullit tonë këtë barrë të rëndë nga supet, do të clirojmë oksigjen dhe energji pozitive për çdo shqiptar. Pse nuk mund të jetojmë më mirë, pse fëmijët tanë duhet të shkojnë nën shtete të tjera për të bërë të shquar, për të shkëlqyer, për tu punësuar, për tu shkolluar dhe për tu përparuar. Pse mos të marrin pagat që meritojnë në vendin tonë, pse kaq shumë prindër e të rinj nuk gjejnë punën e përshtatshme për talentin e tyre për aftësitë edhe prirjet e tyre këtu në Shqipëri por vetëm jashtë saj. Sot shqiptarët e kuptojnë më mirë se meritojnë më shumë se vendi ka nevojë të ndryshojë, njerëzit tanë e kuptojnë se meritojnë më shumë vende pune dhe se Shqipëria e ka të mundur t'ju japë më shumë vende pune dhe se Shqipëria e ka të mundur t'ju jap më shumë vende pune, se meritojnë një qeveri më të mirë, një qeveri që do të punoj për ta dhe jo për veten e saj. Ndjaj me ekipin tonë të mrekullueshëm me qindra ekspert të vendit dhe të huaj kemi përgatitur dhe kemi gati për zbatim plane serioze pune të cilat do të ndryshojnë jetën e familjeve shqiptare, të rinis shqiptare, të grave shqiptare, të çdo kujt që dëshiron të punoj e të jetoj me djersën e ballit, pra të gjithë shoqërisë së drejt e të ndershme shqiptare. Sepse ne do të sjellim një qeveri që do të kujdeset për ju, një qeveri që kujdeset për Shqipërinë tonë. Thirrja ime nga ky shesh është për ty që kërkon një mundësi për të ikur nga ky vend, për ty që ndoshta po mbledh para borxh për të paguar kamionin për Angli duke rrezikuar jetën tënde, mos ik, qëndro, lufto, lufto me mua, lufto me ne. Ky vend mund dhe do të bëhet dhe ti do ta ndërtosh jetën tënde këtu. Thirrja ime është për ty nënë, motër, që punon pa pushim, e që mezi siguron ushqim për fëmijët e tu, mos e lër dhimbjen ta mbush shpirtin tënd, ki besim, ditë më të mira po vijnë për ty dhe të dashurit e zemrës. Thirrja ime është për ty fermerë, që punon gjithë ditën e në fund prodhimet I gropos, mos

u dëshpëro, mos u dorëzo, së shpejti do të kesh në krahë dhe jo kundër qeverinë që meriton, mundi e djersa jote nuk do të shkojë më dëm. Thirrja ime është për ju mijëra familje që pandemia ju ka zhytur në borxhe për të blerë ilaçe, mos u dëshpëroni, nuk do të jeni më të braktisur. Ndryshimi po vjen. Ne do t'ju ndihmojmë. Thirrja ime është për ty sipërmarrës që e mbylle apo që po të falimenton biznesi, mos u dorëzo, qëndro. Shumë shpejt dot të arrish të ringrihesh dhe të shijosh frytet e punës me shumë të ardhura për ty, për familjen tënde, për të punësuarit, me një qeveri në krahun tënd. Për ty është thirrja ime sot kryefamiljar që ke humbur venin e punës dhe sot nuk ke mundësi të kujdesesh për familjen tënde. Nesër do kujdesemi bashkë si një familje e madhe për ty, ekonominë dhe mbarë Shqipërinë. Thirrja ime është për ju gjyshe dhe gjyshër, nëna dhe baballarë që me pensione sot nuk paguani dot as ujë e drita e ilaçe! Nesër do të jetë ndryshe! Dita e dinjitetit dhe mirënjohjes dhe kujdesit për ju, po afron! Që ju të keni më shumë mundësi dhe vendin që meritoni në familjet tona dhe në shoqërinë tonë! Sepse për të gjitha këto dhe shumë më shumë, Shqipëria i ka mundësitë, i ka resurset dhe ne do t'i vëmë në shërbimin tuaj! Miqtë e mi, të rinj dhe të reja studentë dhe studente, lulja e kombit tonë, energjia shpirti dhe forca e këtij vendi, bij dhe bija të Shqipërisë mbushini zemrat me shpresë, bashkohuni me ne për të ndryshuar këtë vend dhe për ta bërë atë si gjithë Europa. Rini shqiptare, çdo gjë e mirë që i ka ndodhur këtij vendi, gjithçka që ka ndryshuar për mirë në këtë vend mban vulën tuaj, ka fyturën tuaj. Ndjaj edhe kësaj herë vendi ka nevojë ju, ndryshimi kërkon mbështetjen tuaj që e keni derdhur në këtë shesh e anembanë Shqipërisë. Për 8 vitet e fundit Shqipëria i është larguar Bashkimit Europian për faj të qeverisjes dhe kryeministrit në ikje. Shëndetësia jonë tregtia jonë, arsimit ynë, shëndetësia, gjithçka vazhdojnë të jenë në krizë, të preken, të varfërohen thellësisht nga fakti që Shqipëria është larg pranimet në Bashkimin Europian. Jetët tona do të jenë shumë më të mira në çdo drejtim ku Shqipëria të plotësojë ëndrrën e saj dhe të bëhet pjesë e Bashkimit europian dhe unë e di se si arrihet kjo. E



# speciale

- Kryetari i Partisë Demokratike hap fushatën elektorale: Jemi këtu të gjithë bashkë dhe jam mes jush sepse ju keni marrë një vendim shumë të rëndësishëm ti japim së bashku fund tranzicionit shqiptar dhe të hapim një faqe të re të historisë moderne dhe europiane të Shqipërisë.
- Të mundësojmë që më të mirët, më të ndershmit të drejtojnë fatet e vendit sepse familja jonë e madhe Shqipëria ka nevojë sot më shumë se kurrë për punë, nder dhe ndryshim rrënjësorë. Sepse ne sot më shumë se kurrë duhet të mbrojmë e të vendosim në vendin e duhur krenarinë tonë të kahershme kombëtare si shqiptarë
- Ne po luftojmë kundër një grushti njerëzish që janë gati të bëjnë gjithçka vetëm për të mbajtur karriget e tyre por në të vërtetë ata nuk na qeverisin por ju shërbejnë vetes dhe ortakëve të tyre që po rrëmbejnë përmes akteve grabitqare gjithçka që ky vend ka, pasuritë tuaj, pasuritë e kombit.
- Ky vend meriton më shumë, shqiptarët meritojnë

- më shumë dhe prandaj ne jemi sot këtu para jush që tua bëjmë të qartë të gjithëve, ne shqiptarët meritojmë më shumë dhe mundemi të bëjmë më shumë dhe do të bëjmë më shumë.
- Çdo gjë e mirë që i ka ndodhur këtij vendi, gjithçka që ka ndryshuar për mirë në këtë vend mban vulën e rinisë, ka fytyrën e saj. Ndaj edhe kësaj herë vendi ka nevojë për rininë, ndryshimi kërkon mbështetjen e saj që është derdhur në këtë shesh e anembanë Shqipërisë
- Unë vi para jush për të shpallur një tjetër synim, një detyrë, një mision që i përgjigjet dëshirës së çdo shqiptari ndaj të cilit dhe ndaj të cilës angazhohem: Kur të më zgjidhni kryeministër detyra e parë madhore, misioni im hyjnor, misioni ynë hyjnor është futja e Shqipërisë në Bashkimin European.
- Të qëndrojmë bashkë sa më afër, të bisedojmë ditë për ditë me njeri tjetrin, të bindim këdo që është në kërkim të shpresës se po punoj për një qëllim të lartë, se po punojmë për një qëllim fisnik, po

- punojmë për të garantuar një ndryshim të thellë, të vërtetë e të pakthyeshëm për bijtë e shqipes. E që ky ndryshim të bëhet realitet secili nga ne duhet ti bashkohet kësaj përpjekjet.
- Unë besoj tek ju, unë jam krenar për ju bashkëqytetarët e mi dhe ndjehem i nderuar për misionin e lartë që më keni besuar. E di që së bashku dhe vetëm së bashku ne do të kapërcejmë çdo pengesë dhe do të përmbushim çdo ëndërr.
- Dashuria për fëmijët, për familjet, për njeri-tjetrin, dashuria për Shqipërinë është forca që na mbush zemrat dhe na ushqen mendjen. Dhe dua që këtë dashuri të mos e përflasë në erë, por t’jua dëshmoj duke u shërbyer drejt rrugës së ndryshimit.
- Ndryshimi që ka filluar që ka zbritur sonte në këtë shesh siç ka zbritur në mendjet dhe zemrat e shqiptarëve kudo ku janë. Bashkë për ndryshimin, bashkë për Shqipërinë i sigurt që së bashku do të fitojmë, Shqipëria do të fitojë.



mbani mend si thonin ishte e pamundur që Shqipëria të hynte në NATO por ne caktuam një pikësynim, punuam fort dhe ia dolëm, sot Shqipëria është falë nesh anëtare e NATO-s. Mbani mend si të gjithë thonin se nuk mund të arrihej marrëveshja për lëvizjen e lirë pa viza, se ishte e pamundur, se s’kishte asnjë shpresë që shqiptarët të lëviznin të lirë, pa viza, me pasaportat e tyre. Por ne caktuam një pikësynim . Ne punuam fort dhe ia dolëm. Sot vij para jush për të shpallur një tjetër synim, një detyrë, një mision që i përgjigjet dëshirës së çdo shqiptari ndaj të cilit dhe ndaj të cilës angazhohem: Kur të më zgjidhni kryeministër detyra e parë madhore, misioni im hyjnor, misioni ynë hyjnor është futja e Shqipërisë në Bashkimin European. Që Shqipëria të jetë e fortë, e përparuar, e mirë për të gjithë, na duhet urgjentisht t’i lëmë pas 8 vite ngecje, 8 vite hapa prapa, 8 vite larg Europës dhe të nisim marshimin tonë të pandalshëm deri në anëtarësimin e plotë të kombit të shqipeve, në familjen tonë europiane! Vëllezër dhe motra, qytetarë dhe qytetare për të arritur këtë çlirim dhe këtë ndryshim, për të arritur këtë aspiratë që sapo ju fola ne, ky ekip që shihni sot dhe unë kam nevojë për ndihmën tuaj sepse pa ju ëndrrat më të bukura, planet më serioze shndërrohen në përralla dhe në pluhur. Pa ju, pa ndihmën e mbështetjen tuaj qëllimet tona për ndryshimin e madh që na pret mbeten thjeshtë ide dhe jo një udhëzues drejt një jete më të mirë. Në javët e ardhme le të qëndrojmë bashkë sa më afër, të bisedojmë dit për dit me njeri tjetrin, të bindim këdo që është në kërkim të shpresës se po punoj për një

qëllim të lartë, se po punojmë për një qëllim fisnik, po punojmë për të garantuar një ndryshim të thellë, të vërtetë e të pakthyeshëm për bijtë e shqipes. E që ky ndryshim të bëhet realitet secili nga ne duhet ti bashkohet kësaj përpjekjet. Bashkë për ndryshim Shqipëria fiton. Sepse nuk mund tua fsheh forca e vërtetë e ndryshimit jeni vetëm ju. Unë jam këtu në mesin tuaj si lajmëtarë, si një udhërrëfyes për të marrë rrugën dhe shtegun e duhur. Kam pra nevojë për ju, për ndihmën tuaj, për forcën tuaj ndaj ju kërkoj sot të më bashkoheni në përpjekjet e fundit e fundit të këtij rrugëtimi për t’i sjellë ndryshim Shqipërisë. Unë besoj tek ju, unë jam krenar për ju bashkëqytetarët e mi dhe ndjehem i nderuar për misionin e lartë që më keni besuar. E di që së bashku dhe vetëm së bashku ne do të kapërcejmë çdo pengesë dhe do të përmbushim çdo ëndërr. Dashuria për fëmijët, për familjet, për njeri-tjetrin, dashuria për Shqipërinë është forca që na mbush zemrat dhe na ushqen mendjen. Dhe dua që këtë dashuri të mos e përflasë në erë, por t’jua dëshmoj duke u shërbyer drejt rrugës së ndryshimit. Ndryshimi që ka filluar që ka zbritur sonte në këtë shesh siç ka zbritur në mendjet dhe zemrat e shqiptarëve kudo ku janë. Bashkë për ndryshimin, bashkë për Shqipërinë i sigurt që së bashku do të fitojmë, Shqipëria do të fitojë. Ju faleminderit shumë! Zoti e bekoftë Shqipërinë!

**(FJALA E KRYETARIT TË PD, LULZIM BASHA NË HAPJEN E FUSHATËS ELEKTORALE NË SHESHIN “NËNË TEREZA” TIRANË, MË 25 MARS 2021)**

***Rama e kujton vehten si më të mirin, kurse të tjerë nuk paska! E mendon vehten si Enver i ri që po të na ikte, do të na shembej bota. Mendësi e mjerë!***

## Rama na bindi se duhet të ikë një orë e më pare

- Fjalimi i Kryerilindasit në hapjen e fushatës elektorale ishte një tjetër argument se përse Rama duhet të largohet sa më shpjet nga qeverisja. Ai e mendon veten si Enveri, urren opozitarizmin dhe popullin e thjeshtë, bëhet ekspert për gjithçka, mendon se mund t’ju zëvendësoi njerëzve bukën dhe punën me llafazanëri-gënjeshtërash, me 3 D dhe “ambalazhin me ngjyra” nga jashtë

*Fjalimi i kryerilindasit Rama në hapje të fushatës elektorale të PS më 25 mars ishte një tjetër argument krejt i freskët se përse ai duhet ikë një orë e më parë prej qeverisjes së vendit! A e dini përse mendoj kështu?*

- 1- Rama e kujton vehten si më të mirin, kurse të tjerë nuk paska! E mendon vehten si Enver i ri që po të na ikte, do të na shembej bota. Mendësi e mjerë! Ende nuk e ka kuptuar se në demokraci nuk ka njerëz të pazëvendësueshëm, aq më shumë kur janë te provuar dhe të dështuar!
- 2- Rama urren opozitën, por përsëri si i mjeruar, sepse të gjithë fjalimit te tij nuk mundi të mos i hedhë vrer, sharje dhe shpërfillje për opozitën, si gjithnjë. Nga fillimi deri në fund të llafazanërisë-sëmundje të tij që po përhapet si covid-truri ndër “rilindasit”, sidomos te ai i Tiranës, këtë punë bëri dhe ndoshta e ndjen frikën e ndëshkimit në këtë fundprill! Ai e urren gjysmën e popullit të vet, që mendon ndryshe prej tij dhe “rilindasve” të tjerë. E si mund të pretendojë të vazhdojë të udhëheqë njerëzit, që e tregon përditë se i shpërfill, tall dhe urren?! A e shikojnë të gjithë se çfarë “udhëheqësi” është?
- 3- Rama kujton po aq mjerisht, se vetëm politika i bën punët dhe sidomos ai vetë, si kryerilindas, duke shpërfillur qindra mijë shqiptarët që punojnë si specialistë në fusha të ndryshme të jetës shoqërore. Ai harron se opozita do t’i bëjë punët më mirë se të dështuarit “rilindas” dhe me të njëjtët njerëz. Pra opozita, do apo nuk do ai, do ta marrë pushtetin dhe do të qeverisë shumë më mirë se “rilindasit” e te-

*jkorruptuar. Dhe do të qeverisë jo si “rilindasit”, si kalorës të vetmuar, por bashkë me popullin, si një i vetëm, i pandarë në të pëlqyer dhe të urreyer, siç bën “kryerilindasi”.*

- 4- Rama është mjerisht plot “iluzione estetike dhe gramatikore” mbi zhvillimet shoqërore. Ai mund të ketë bërë gjëra ndoshta estetikisht të bukura, por shoqëria disa milionëshe shqiptare nuk jeton me bukuri estetike të detyruara vetëm se i pëlqejnë atij, ndonëse edhe ato duhen. Ai duhet të mësojë se më e rëndësishme se të harrosh një pikë, apo presje të një fjalimi, më e rëndësishme se një gjetje estetike si trëndafili socialist i parë nga lart i mbrëmjes së pardjeshme “rilindase” është vendimarrja e duhur për një popull që kërkon ta udhëheqësh. Rama kujton se po të mbajë fjalim-hartime e ka kryer punën e tij. Prandaj ai në tetë vjet ka ndërtuar një realitet kryesisht “verbal”, fjalaman dhe ka dehur para se gjithash vehten, duke kujtuar se ka kënaq-gënjyer shqiptarët.
- 5- Rama vazhdoi edhe në fjalën e tij të hapjes së fushates politiken e tij tetëvjeçare të “ambalazhimit të bukur” të një Shqipërie turistike që ta shijojnë vetëm turistët e huaj, të pasurit dhe ata që për politikë jane gati të sakrifikojnë mirëqënien e tyre vetiake dhe familjare. Ai ka harruar se koha e tij mbaroi, kurse katër vjetët e fundit ua vodhi shqiptarëve. E si mund të kesh katër vjet të tjerë një të tille kryeministër vehtedashurues, moskuptues dhe shpërfillës për të tjerët dhe të maskuar si dashurues të popullit?!





Ka qenë përkushtimi i njerëzve me të cilët kam punuar që ka bërë të mundur ëndrrën e anëtarësimit në NATO, apo heqjen e vizave



Lulzim Basha: PD ka resurse për të bërë disa lista kandidatësh për deputetë, parimi kryesor që udhëhoqi procesin qenë vlerat

Kryetari i PD, Lulzim Basha ka folur në emisionin “Kjo Javë” të Nisida Tufës në Neës24 për pjesën në librin e tij ku flet për listat dhe për kritikën që ka marrë për kandidatët që ka vendosur në listat e 25 prillit.

Basha tha se, procesi që ndodhi herën e fundit në PD ishte i hapur dhe unik në Ballkan. Sipas tij, PD ka resurse për të bërë jo 1 apo 2 por disa lista kandidatësh për deputetë.

Ai garanton se kësaj here listat e PD janë bërë me parimin kryesor të udhëhequr nga vlerat e kandidatëve.

**Pyetja:** Për ta kaluar pjesën e reflektimit, këtu ju keni perceptuar ato kritikën që ju keni marrë në politikë, siç është edhe hartimi i listave, për shembull, dhe ju thoni se përse nuk përfshiva në listë dikë apo dikë tjetër dhe tani ne shtrojmë pyetjen: Po të rinjtë ku do ta kenë hapësirën? Kush do të përfshijë? Listat kanë qenë pjesë e fortë Zoti Basha, sidomos ato të kaluarat, për kritikën pikërisht për këtë pjesë që unë po përshkruaj. Po listat që janë hartuar tani si i keni?

Lulzim Basha: Është një proces unik i ndodhur për herë të parë në Shqipëri dhe në Ballkan i cili ka përfshirë të gjithë anterinë e Partisë Demokratike, ka përfshirë një konsultë që ka zgjatur me muaj, ka përfshirë një proces seleksionimi dhe mbi të gjitha ka qenë një proces i hapur jo i mbyllur. Pa diskutim Partia Demokratike posedon mijëra resurse njerëzore për të hartuar jo një, as dy por shumë lista kandidatësh për deputet, por ajo që është e rëndësishme është që besnik ndaj asaj që kam deklaruar kriteri kryesor apo le të themi parimi kryesor që ka udhëhequr këtë proces kanë qenë vlerat. Pra, të shikuarit e Partisë Demokratike ashtu siç lindi në ditët e saj të para si një zëdhënës, si një përfaqësuese e interesit qytetar jo si një operacion në vetvete për përfitimin e vet politik por si një zëdhënëse, si një përfaqësuese, si një përçuese e shpresës së shqiptarëve për ndryshim.

**Pyetja:** Zoti Basha të mbetemi pak te kjo linjë dhe për ta hequr këtë pjesën e kritikave. Ju përshkruani se dikush mund t’ju ketë cilësuar edhe si aksioner në minorancë e partisë tuaj, jo vetëm vetëm por edhe në praninë e të tjerëve, sa ju ka goditur? Sa ju ka dëmtuar kjo? Si e perceptoni?

Lulzim Basha: Shiko unë mendoj se një nga pikat më të forta të mia është konsultimi me bashkëpunëtorët e mi, rrahja e mendimit dhe padiskutim ky ka qenë edhe një nga kyçet e sukseseve me të cilat është shënuar një pjesë e rrugëtimit tim politik. Ka qenë aftësia e profesionistëve që më kanë rrethuar, natyrisht edhe e ekspertëve të huaj që bëri të mundur që në një kohe re-

kord, në më pak se dy vite, ne të ndërtonim një vepër të tillë të madhe si rruga e kombit. Ka qenë përkushtimi i njerëzve me të cilët kam punuar që ka bërë të mundur ëndrrën e anëtarësimit në NATO, apo heqjen e vizave. Dhe pa diskutim edhe në sfidat opozitare është shpirti i kolegjalitetit, i diskutimit të hapur, që unë e konsideroj së pari një veti timen, një karakteristikë timen që ma bën më të lehtë përballjen me sfidat që opozitarizmi në përgjithësi dhe në veçanti opozitarizmi i këtyre viteve në Shqipëri, por po kështu e shikoj edhe si një aset për të ndërtuar kulturën e kolegjalitetit, e vendimmarrjeve të hapura të përbashkëta. Dhe ajo që dua të garantoj Shqiptarët është që fryma e kolegjalitetit, e transparencës dhe jo arroganca apo sundimi i njëshiti do të karakterizojë edhe qeverisjen time të nesërme. Mendoj që një nga arsyt kryesore pse jemi katandisur këtu ka qenë arroganca e njëshiti, ka qenë shpërfillja e mendimit të të tjerëve, e mendimit ndryshe dhe mbi të gjitha ka qenë shkatërrimi i mekanizmit të institucioneve, të vendimmarrjeve institucionale, të sundimit të ligjit, mbisundimin e njëshiti. Dhe me mua demokracia është e garantuar, kolegjaliteti, fryma e transparencës e diskutimit të hapur është e garantuar, ky është mesazhi që jap përmes atij kapitulli që ju referuat.

“100 dështimet e Ramës”, Basha: Shqipëria, me nivelin më të lartë të borxhit publik në rajon

Kryetari i PD-së, Lulzim Basha është ndalur sërish tek një nga ‘dështimet’ e kryeministrit Edi Rama, 26 ditë para zgjedhjeve të 25 prillit.

Përmes një postimi në rrjetet sociale, lideri demokrat thekson se Shqipëria është vendi me nivelin më të lartë të borxhit publik në rajon.

“26 ditë deri më 25 prill. Cili është vendi me nivelin më të lartë të borxhit publik në rajon? Shqipëria. Shqipëria ka sot nivelin më të lartë të borxhit publik në rajon dhe ndër më të lartët në Europë.”, -shkruan Basha.

**PD: Plan konkret pune që ofron trajnim të dyfishtë profesional**

- **Komisionerja Gabriel:** Arsimi kërkon një qasje vizionare dhe bashkëpunim më të thellë në nivelin europian.
- **Komisionerja Gabriel për planin Basha:** Kjo iniciativë me aleancat universitare është një nga më të rëndësishmet
- **Basha:** 5 gjuhë të huaja falas për çdo shqiptar, kudo ku jeton
- **Basha:** Kemi një plan konkret pune që ofron trajnim të dyfishtë profesional në mbi 20 disiplina të ndryshme
- **Basha:** Qëllimi ynë, për të ndërtuar dhe mbështetur një klasë të mesme të trajnuar mirë dhe të paguar mire
- **Basha:** Për të sjellë këtë ndryshim të vërtetë; ne duhet të fillojmë një rrugë të sigurt drejt BE-së
- **Basha:** Ne duam të jemi të parët dhe jo në bisht sic kemi qenë gjatë këtyre 8 viteve.
- **Basha:** Është privilegj që të kem në krahun tim universitet europiane, qendrat e ekselences





# kandidati

**Demokratët e Bulqizës, Dibrës, Matit janë të sigurtë në fitoren të tyre të 25 prillit. Unë kam premtuar se do të jem një përfaqësues i denjë, shoku dhe vëllai i tyre, ua di hallet, problemet dhe shqetësimet dhe do të jem zëri i tyre i vërtetë në parlamentin shqiptar.**

# Jam i sigurtë në fitore !



NGA EDMOND ISAKU

- ***Jam i bindur se në gjendjen aktuale që është Bulqiza dhe në tërësi qarku Dibër garanton fitoren e thellë të PD-së, duke parë këtë përkushtim të shumëfishuar të strukturave, të mirëorganizuara dhe të motivuara nga shtabi qendror i qarkut nën drejtimin e Xhelal Mziut. Mesazhet e fitores po përcillen përmes një organizimi që në qelizë, në të gjithë strukturën, duke i marrë seksionet një për një, duke shpalosur programin tek çdo familje duke u mbështetur dhe evidentuar kontributet, vlerat dhe arritjet e mëparshme, duke kërkuar dhe vënë në lëvizje gjithë potencialin intelektual të qarkut si dhe duke afruar potenciale të reja njerëzore që na mbështesin, duke zgjeruar dhe krijuar frymëmarrje përtej strukturave, duke motivuar një dialog me anëtarët dhe simpatizantët tanë dhe votuesit gri, që nuk janë pak por kanë nevojë t'u gjendemi afër dhe t'ju rrisim besimin dhe shpresën, me premtimin se do të jemi në krah të tyre dhe nuk do t'i zhgënjëjmë***

Unë punoj në sektorin privat në punë dhe investime modeste, duke fituar me djersë dhe ndershmëri. Asetet me impakt publik, si TV Bulqiza, firma "Isaku", Shoqata e Transmetuesve Radiotelevizivë Kabllorë Valorë Kombëtarë që drejtojnë, gazeta kulturore atdhetare "Bulqiza", janë përgjithësisht punët e mia, ku modestisht mund të them se kam patur sukses. Kam një kompleks shërbimesh publike, si restorantin dhe hotelin Bulqiza, që besoj është një vlerë e shtuar e qytetit të Bulqizës si vepër turistike me performancë cilësore duke ofruar shërbim modern në këtë qytet të aneksuar të Shqipërisë.

Dëshira për të konkurruar si deputet dhe përfaqësues i elektoratit të Bulqizës, buron nga dëshira për të ngritur në një shkallë më të lartë edhe rolin e kontributit të Partisë Demokratike.

Kur mora përsipër të drejtoj degën e PD -së Bulqizë, si nënkryetar i saj, ishte dëshirë për të kontribuar personalisht, në zhvillimin dhe zgjerimin e degës, motivimin e anëtarëve dhe simpatizantëve, afrimin e tyre dhe të gjithë votuesve që i kemi patur ndër vite, për të maksimalizuar pjesëmarrjen dhe rezultatin elektorale për partinë tonë duke i paraprirë

betejës elektorale që po zhvillojmë tani. Unë mora përsipër të kontribuoj në këtë degë, duke u mbështetur në mundësitë e mia intelektuale, morale, materiale, psikologjike dhe respektit të pa lëkundur që kam në vlerat e demokracisë, si përfaqësues i djathtë i saj nga viti 90-të e deri më sot. Unë përkrah dhe vlerësoj alternativën e PD-së për mesazhin e saj demokratik e kombëtar, si alternativë e lirisë dhe demokracisë për Shqipërinë dhe shqiptarët.

Kam punuar ndër vite në sektorin privat duke respektuar ligjet dhe rregullat e shtetit ligjor dhe të ekonomisë së tregut. Jam i pa implikuar me detyra publike dhe afëra me fonde publike.

E dua qytetin tim Bulqizën dhe gjithë investimet e mia në fushën e medias, të ndërtimit dhe nxjerrjes së kromit, i kam fokusuar pikërisht në këtë qytet, duke punësuar dhe mbështetur qindra familje. Edhe investimin tim politik, si përfaqësues i forcave të djathta, si këshilltar në Bashki për katër mandate e kam dhënë në mbështetje të vazhdueshme të forcës kryesore politike, lokomotivës së forcave të djathta shqiptare, Partisë Demokratike. Kurrë nuk kam devijuar dhe nuk kam mbështetur forcat politike të majta.

Jam i bindur se në gjendjen aktuale që është Bulqiza dhe në tërësi qarku Dibër garanton fitoren e thellë të PD-së, duke parë këtë përkushtim të shumëfishuar të strukturave, të mirëorganizuara dhe të motivuara nga shtabi qendror i qarkut nën drejtimin e Xhelal Mziut. Mesazhet e fitores po përcillen përmes një organizimi që në qelizë, në të gjithë strukturën, duke i marrë seksionet një për një, duke shpalosur programin tek çdo familje duke u mbështetur dhe evidentuar kontributet, vlerat dhe arritjet e mëparshme, duke kërkuar dhe vënë në lëvizje gjithë potencialin intelektual të qarkut si dhe duke afruar potenciale të reja njerëzore që na mbështesin, duke zgjeruar dhe krijuar frymëmarrje përtej strukturave, duke motivuar një dialog me anëtarët dhe simpatizantët tanë dhe votuesit gri, që nuk janë pak por kanë nevojë t'u gjendemi afër dhe t'ju rrisim besimin dhe shpresën, me premtimin se do të jemi në krah të tyre dhe nuk do t'i zhgënjëjmë.

Fushata elektorale tregon se po ndizet një shpresë e re, fitore e thelle e të djathtëve në qarkun e Dibrës, me në krye Partinë Demokratike dhe kryetarin e saj, kryeministrin e ardhshëm, zotin Lulzim Basha. Programi ekonomik i Partisë Demokratike është aktualisht i pa konkurrenshëm nga asnjë forcë politike dhe i vetmi që siguron zhvillim të qëndrueshëm dhe integritet të Shqipërisë në Europë.

Zoti Basha po shpalos një program elektorale të realizueshëm dhe premtues për të ndryshuar jetën ekonomike, sociale dhe kulturore të qytetarëve shqiptarë. Konkretisht në zonën e Bulqizës dhe në të gjithë qarkun e Dibrës po komunikojmë me njerëzit dhe hallet e tyre për të mudësuar zgjidhje dhe afruar përkraje për të gjithë ata që ndjehen të pambështetur dhe gjatë këtyre katër viteve kanë rënie të theksuar në ekonominë e tyre familjare. Me përkushtim dhe këmbëngulje stafi elektorale po përçon në seksione dhe në masën e gjerë të votuesve mesazhet madhore demokratike të alternativës sonë që na vijnë nga qendra. Duhet falenderuar për motivimin e fuqishëm të gjitha strukturat e degëve, kryetarët dhe sekretarët e seksioneve dhe së bashku me ato të partive aleate të djathta që po shumëfishojnë mbështetjen e PD-së dhe të elektoratit të djathtë. Objektivi ynë për zgjedhjet elektorale të 25 Qershorit është që e djathta e bashkuar të marrë katër deputetë nga pesë që ka qarku i Dibrës. Unë e kam përvojën, moshën, fuqinë intelektuale, morale, materiale që t'i përkushtohem detyrës së deputetit, duke premtuar se, nëse do të fitoj mandatin e deputetit, nuk do t'ju zhgënjëjë, këtë e them edhe në emër të kandidatëve të tjerë të listës që i konsideroj vlera të çmuara intelektuale të brezit të ri të politikanëve me një integritet shumë të lartë moral dhe intelektual. Një bashkëpunim shumë të

mirë kemi me aleatët tanë të djathtë ku i trajtojmë problemet me tolerancë, me diversitet mendimi, e pranojmë njëri-tjetrin të ndryshëm brenda programit tonë madhor.

Po bashkëpunojmë dhe afrojmë njerëz që kanë ndikim dhe me reputacion shoqëror duke krijuar një hapje ndaj vlerave për një frymë të re në degën tonë të PD -së. Kjo frymë dhe të bashkuar të realizojmë objektivin e fitores së thellë të PD-së në Bulqizë dhe në gjithë qarkun e Dibrës, për të realizuar modelin e ri politik siç po punon kryesia qendrore e PD-së, nën drejtimin e zotit Lulzim Basha.

Gara vazhdon me besim të thelle te fitorja jonë si në vitet e para të demokracisë plot besim dhe optimizëm te e djathta. Besimi lëviz malet, thotë një shprehje, dhe këtë besim ne e bazojmë te alternative jonë programore për një ekonomi të forte që e çliron individin nga skamja, pasiguria, varfëria dhe papunësia.

Demokratët e Bulqizës, Dibrës, Matit janë të sigurtë në fitoren të tyre të 25 prillit. Unë kam premtuar se do të jem një përfaqësues i denjë, shoku dhe vëllai i tyre, ua di hallet, problemet dhe shqetësimet dhe do të jem zëri i tyre i vërtetë në parlamentin shqiptar. Ata janë të varfër dhe të pa punë por me shpirt dhe zemër të mbushur me shpresë se një ditë drejtësia në këtë vend do të vijë, do të hapen vendet e punës, do të gjallërohet tregu i lirë dhe ekonomia e vendit, do të ulen taksat dhe të vendosen rregullat dhe standartet e demokracisë dhe të shtetit ligjor. Këtë shpresë ato e shikojnë vërtetë te Partia Demokratike dhe Aleanca e Djathtë që sa vjen e zgjerohet dita-ditës.

Në vitet e qeverisjes së Ramës, droga mbuloi vendin, papunësi, varfëri, stanjacion ekonomik, debate politike shterpë, përçarje dhe denigrim politik, krimi i instaluar në sistem, korrupsion në çdo institucion, mashtrim në mbajtjen e premtimeve, konçensione jo transparente, dhunë verbale mbi mediat, ngushtim të lirisë ekonomike të biznesit, asnjë ngritje pagash dhe pensionesh përbëjnë portretin dhe shembëlltyrën e qeverisë Rama.

Në të gjitha takimet që kemi organizuar në çdo lagje dhe fshat ne kemi shpalosur programin tonë rajonal që është detajim në përputhje me programin qeverisës të PD-së. Së pari të përmirësojmë situatën ekonomike që do të na çojë në rritjen e integritetit dhe mirëqënies së familjes. Pa familje të shëndoshë dhe të fuqishme ekonomike edhe shoqëria është e dobësuar. Vlerat tona familjare, morale, intelektuale, kombëtare dhe kulturore janë në themel të programit të PD-së. Pa mëkëmbje të ekonomisë nuk ka integritet. Ne do të shkojmë në Europë kur të plotësojmë standartet e e kërkuara nga BE, kur të zhvillojmë ekonominë, arsimin, kulturën, kur të kemi të gjithë ku të punojmë dhe të marrim një pagë, ku të gjithë së bashku të zbatojmë ligjin dhe rregullat e shtetit dhe shoqërisë dhe ku të gjithë së bashku të gëzojmë hapësirat e lirisë që na dhuroi demokracia shqiptare, Partia demokratike e Shqipërisë. Unë e shikoj biznesin si fusha që gjeneron vende pune. Padyshim që një rol të rëndësishëm në hapjen e vendeve të reja të punës që është faktor kyç në zhvillimin ekonomik është çlirimi i biznesit nga barra fiskale. Ulja e tatimit mbi fitimin në 9 përqind, taksat e ulta do të gjallërojnë dhe do të rrisin bizneset në treg duke rritur punësimin dhe reduktuar varfërinë. Ne nuk e quajmë zgjidhje hapjen e mensave publike për të varfërit por punësim dhe rritje të asistencës që çdo shqiptar të plotësojë nevojat bazë të jetesës. Sjellja e qeverisë aktuale me biznesin ka qenë jo e përshtatshme, jomotivuese dhe dhe arroganca fiskale ndaj tij ka çuar në falimentim dhe mbyllje. Ne mbështetemi në alternativën qeverisëse të PD-së duke vënë theksin në zhvillimin ekonomik të shoqërisë shqiptare dhe integritimin europian të Shqipërisë. Në të gjithë qarkun e Dibrës tashmë po

(Vijon në faqen 7)



EDMOND ISAKU: SË BASHKU PËR FITOREN E MADHE,  
ME LULZIM BASHËN KRYEMINISTËR-PROJEKSION I SHQIPTARËVE

profil

# EDMOND ISAKU: SË BASHKU PËR FITOREN E MADHE, ME LULZIM BASHËN KRYEMINISTËR-PROJEKSION I SHQIPTARËVE

**MË VOTONI, DO TË PËRFAQËSOJ INTERESAT TUAJA NË PARLAMENTIN E RI SHQIPAR...**

**Të nderuar miq!**

Tashmë që gara elektorale ka startuar, dhe mu a m'u dha besimi nga lider shipi demokrat të jem Nr.4 në listën e kandidatëve të PD në qarkun e Dibrës, shpreh bindjen e palëkundur në mbështetjen tuaj, për të maksimalizuar votën për PD-në dhe për të garantuar **FITOREN TONË TË MADHE**.

Kandidimin tim e konsideroj vlerësim maksimal të kontributit dhe karrierës time gati 30-vjeçare për Partinë Demokratike...

Kam besim të plotë në mbështetjen tuaj dhe të gjithë qytetarëve të Dibrës, Matit, Bulqizës, Maqellarës, Shpenzës e Gjoricës, Ostrenit, Trebishtit e Oksh-tunit, Zerqanit, Fushë Bulqizës e Martaneshit.

Le të punojmë së bashku, shtëpi më shtëpi, familje më familje e me këdo që dëshiron ndryshimin e shumëkërkuar.

**I juaji  
Mond Isaku**



## Edmond Isaku, një kandidat dinjitoz

**I** lidhur prej dekadash me banorët bulqizakë, Edmondi do të jetë një përfaqësues real i popullit të Bulqizës në Parlamentin shqiptar. Edmond Isaku është zgjedhja e duhur për Bulqizën që do të na përfaqësojë me dinjitet në parlamentin e ri.

Qytetarët bulqizakë vlerësojnë tek Edmondi qëndrimin e respektuar të tij në komunitet, ku bashkë me familjen janë shembull në marrëdhënie me bashkëqytetarët, si dje kur punonte specialist në minierë ashtu edhe sot që tashmë është nga biznesmenët e suksesshëm të Bulqizës.

Edmondi është njeri vizionar i orientuar saktë në ekonominë e tregut që me kurajo filloi biznesin dhe arriti të krijoj TV Bulqizën; Firmën "ISAKU" duke arritur sukses në ngritjen e tij ekonomike duke zbatuar ligjet me ndershmëri. Që kur ishte në hapat e para kishte ide dhe guxim për të ecur në biznes. Ai realizoi për here të parë spektaklin "Miss Bulqiza" kur kishte shumë pak të ardhura, duke e treguar vehten se e don këtë vend të zhvilluar si në Evropë. Ai e mban vehten ngushtësisht të lidhur me këtë qytet duke dhënë shembullin e tij në orientimin e investimeve ku ngriti në qendër të qytetit të Bulqizës kompleksin bashkëkohorë mediatik të TV, hotelin e restorantin ku sot mund të akomodohen autoritete zyrtare të rangjeve të larta dhe turistë duke i dhënë emër Bulqizës në hartën turistike, gjë që i ka munguar këtij rrethi.

Edmond Isaku është biznesmeni i Bulqizës që ka mbështetur financiarisht projekte kulturore, sportive, mediatike e sociale duke dhënë shembullin e tij se ai tundohet nga dashuria për këtë vend ku jeton qysh prej rinisë së tij. Edmondi ka aftësi të spikatura për të vlerësuar pozitivisht idetë që ngrenë më lart emrin e Bulqizës. Ai ka mbështetur botimin e "Gazetës Bulqiza" dhe hapjen e faqes në internet, duke bërë të mundur për çdo emigrant që të njihen me zhvillimet në vendlindjen

e tyre. Ai është me vizion perëndimor për zhvillimin e ekonomisë dhe kulturës dhe bashkëpunues në zbatim të ideve progresiste. Bisedat me Edmondin përfundojnë me vendime: Hajde ta bëjmë – kur është fjala në shërbim të Bulqizës.

Përvoja që ka sot Edmondi dhe arritjet e tij janë faktor i rëndësishëm që ai ta përfaqësojë Bulqizën në parlamentin shqiptar. Ai është njeriu i duhur që e njuh këtë komunitet për të gjitha hallet që ka, që t'i bëjë ato objekt debati për t'i vendosur në rrugën e zgjidhjes e të zhvillimit të Qarkut Dibrës, duke filluar me mbarimin e Rrugës së Arbërit si prioriteti për dibranët.

Edmond Isaku duke iu bashkuar ekipit vizionar e fitues të kryeministrit të ardhshëm të vendit, z.Lulzim Basha që po shpalos programin real për ekonomi të fortë dhe shtetin në dorë të qytetarëve, do ta vendosë të sigurtë Dibrën dhe gjithë Shqipërinë në rrugën e zhvillimit duke u ndarë përfundimisht nga krimi dhe droga. Edmondi po punon së bashku me ekipin fitues të deputetëve të qarkut Dibrë, të cilët janë përzgjedhja më e mrekullueshme ndër vite për këtë qark që drejtohet nga politikani dhe administrator i shquar Xhelal Mziu, deputetja me integritet të lartë moral dhe politik Dhurata Çupi, diplomati ekselent Kreshnik Çollaku e mjaft personalitete të tjerë me reputacion në listën e PD dhe koalicionit të djathtë. Ky përfaqësim dinjitoz kofiguron një përfaqësim të niveli të lartë ndër inteligjencën e lider shipit të djathtë shqiptarë përballë figurave rurale dhe tej të konsumuara të të majtës. Dibra këtë herë do të realizojë një fitore spektakolare të opozitës, ku duket në interesimin për të ndryshuar qeverisjen aktuale si një dyndje biblike për të dalë nga kriza ku kemi rënë.



# Basha publikon librin 'Misioni im'!

**T**IRANË, 22 Mars, 2021 - Kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha ka nxjerrë në treg librin e tij të parë të titulluar 'Misioni im'. Në libër flitet për sfidat e opozitës së këtyre 8 viteve, si dhe për arsyet se pse PD duhet të vijë në pushtet. Kopertina e librit mban foton e kryedemokratit Lulzim Basha, emri i tij i shkruar me shkronja kapitale të bardha, ndërsa titulli i librit po ashtu i shkruar me shkronja kapitale me ngjyra të kuqe.


Për promovimin e librit, Basha mbajti ditën e sotme një takim me të rinjtë, aty ku iu përgjigj pyetjeve që kishin në lidhje me librin si dhe tregoi disa informacione më tepër për atë që është shkruar. Kryedemokrati ishte i pranishëm me botuesen, njëkohësisht me kandidaten e Partisë Demokratike për deputete, Flutura Açka. Basha bëri të ditur se librin e ka shkruar në periudhën e karantinës, duke shtuar se është një prodhim i muajve, mars, prill dhe maj.

Basha bëri të ditur se libri nuk është një rrëfim autobiografik dhe as një përktim i programit politik të Partisë Demokratike, mirëpo është një letër e hapur drejtuar shqiptarëve, në veçanti rinisë për një angazhim të drejtpërdrejtë në politikë, për një pjesëmarrje në publikun në jetën publike si rruga e vetme për të siguruar ndryshimin.

Për më shumë bëhu pjesë e grupit më viral në Facebook, Dosja.al

Kryedemokrati shtoi se ftesa i bëhet qytetarëve në mënyrë që ti japin fund plogështisë dhe të gjejnë kurajo për të lënë pas të pa pranueshmen. Politika e mirë i zgjidh problemet pa teatër ndërsa politika e keqe ka nevojë për teatër për të fshehur pikërisht të keqen - tha ndër të tjera kryetari i Partisë Demokratike.

Botimi i librit është bërë nga shtëpia botuese "Skanderbeg" që drejtohet nga Flutura Açka, e cila është dhe kandidante për deputete e Partisë Demokratike.



- **Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka botuar librin me titull "Misioni im". Me këtë libër Basha kërkon që t'u japë një mesazh shqiptarëve që ta votojnë ata në zgjedhjet e 25 Prillit, pasi tregon misionin e tij që ka për qeverisjen e vendit**
- **Kreu i PD-së: E shkrova në dy muaj**

karantinë, është një letër e hapur drejtuar gjithë shqiptarëve

Në **"Misioni im"**, Basha rrëfen të gjitha ngjarjet gjatë karrierës së tij politike, si i ka përjetuar që nga viti 1992, dhe betejën opozitare të viteve të fundit.

**Lulzim Basha**

Botuesja Flutura Açkaj bëri të ditur në fund të aktivitetit promovues se libri i Bashës, përveç vitrinës do të jetë

dhe në bibliotekë. Vetë kryedemokrati theksoi se librin e ka shkruar gjatë periudhës së karantinës, dy muajt që

i gjithë vendi ynë ishte në izolim total, ndërsa në pjesën tjetër të muajve, ka bërë një rishikim të tekstit.

## Jam i sigurtë në fitore !

(Vijon nga faqja 5)

shpalosim programin elektoral dhe po gjejmë një me përkrahje dhe mbështetje të madhe si alternativë gjithëpërfshirëse.

Seksionet e PD-së si themeli i partisë e kanë pritur dhe po punojnë me kënaqësi në të gjithë qarkun e Dibrës. Deri tani në takimin e prezantimit tim si kandidat për deputetë kam patur një mbështetje të sinqertë. Kam vendosur një dialog të shtruar, me një dashamirësi të admirueshme, për të gjitha hallet, shqetësimet dhe problemet e zonës dhe i kemi të detajuar, me një alternativë të shkruar ku objektivizohen synimet dhe alternativat tona përballë elektoratit.

Po mundohem të shfrytëzoj gjithë reputacionin që kam krijuar në Bulqizë, Dibër dhe Mat për të maksimalizuar rezultatin zgjedhor dhe për të arritur një

fitorë të thellë të Partisë demokratike në këtë qark. Objektivi im është që të arrijë 14 mijë vota nën emrin tim, atëherë e quaj të realizuar veten time në këtë mision që kam ndërmarrë.

Njerëzit siç thoshte Migjeni, çdo ditë "po shohin qartë e më qartë dhe vuajnë thellë e më thellë." Republika e re, një shpresë e re!

Tetë vjet kaluam një periudhë me qeverisjen më të dobët. Qytetarët e Bulqizës po përjetojnë varfërimin e mëtejshëm si pasojë e rritjes së papunësisë dhe e moskujdesjes së strukturave shtetërore ndaj tyre. Kryeministrit aktual Edi Rama i kanë rezultuar gënjeshtra premtimet e deritanishme.

**Populli pret ndryshimin e madh. Dita po afron.  
Më 25 prill fiton Bulqiza, Dibra, Mati, fiton gjithë Shqipëria !**



Jam kandidati i vetëm i Bulqizës, që përfaqësoj Bulqizën, dhe do ta përfaqësoj denjësisht

intervista

# Përse në zgjedhjet e 25 prillit duhet votuar Edmond Isaku

**Tvb:** Prej sa kohësh je përfshirë në politikë?

E.I.: Kam qenë anëtar i Pd, por seriozisht në këtë forcë politike jam përfshirë në vitin 2016.

**Tvb:** për Ju është hera e dytë që garoni për deputetë, sa shpresë keni që këtë herë do të fitoni?

E.I.: Kjo renditje që ky kod zgjedhor paraqet, nuk më frenon mua dhe asnjë kandidat tjetër që të dalë i pari dhe të fitoj.

**Tvb:** Sa janë pritshmëritë tuaja në këto zgjedhje?

E.I.: Unë pretendoj që në rrethin e Bulqizës, të marrë 8 mijë vota, për këtë shifër vë bast me çdo kandidat tjetër. Në bazë qarku Peshkopi, Burrel, Bulqizë do të marrë 14 mijë vota.

**Tvb:** Përse në zgjedhjet e 25 prillit duhet votuar Edmond Isaku.

E.I.: Cilësia ime është ndershmëria, cilësia ime është sinqeriteti, cilësia ime është puna. Ka vetëm një kryefjalë : vetëm djersa! Nuk kam unë asnjë lloj kompleksi, jam ndryshe nga të gjithë.

**Tvb:** Në Dibër për herë të parë në këto zgjedhje ka dhe një kandidat të pavarur që duket se e ka marrë seriozisht garën. Ju si e komentoni?

E.I.: Më vjen keq që një minator për shkak të mërziqes, me të drejtë, për shkak të lodhjes së madhe që kjo qeveri dhe qeveritë e tjera deri tani, u kanë shkaktuar minatorëve, duke mos miratuar statusin shumë të kërkuar, dhe për shkak të kësaj mërzie, për shkak të kësaj revolte, një minator, një djalë i zonës tonë, djalë shumë i mirë, ish anëtarë i Pd, duke shprehur revoltën e tij, duke marrë pjesë, duke u bërë pjesë e kandidimit në mënyrë që në mendjen e tij, në vetëdijen e tij, në vullnetin e tij, mendon se mund të realizojë këtë gjë. Por kodi zgjedhor nuk ia jep këtë shans.

**Tvb:** Partia Demokratike e ka në programin e saj qeverisës statusin e minatorit?

E.I.: Opozita, Pd dhe koalicioni i djathtë garanton statusin e minatorit. Ne kemi dërguar një projekt i cili garanton që shuma e lekëve që ky status kërkonte për t'u kompletuar ishte 56 milion dollarë. Nga këto 22 milionë i paguan shteti dhe pjesën tjetër kom-



panitë private.

**Tvb:** Me çfarë programi do të dalë Pd dhe koalicioni opozitar në këto zgjedhje?

E.I.: Pd, jashtë programit makro, fillon që ditën e parë që merr qeverisjen Basha të hiqet 240 lekëshi, që hiqet menjëherë duke filluar program për rritjen e rrogave, me uljen e sigurimeve, me 9 % që do të jetë taksa e sheshtë, që u jep mundësi gjithë popullatës të kenë lekë në xhepat e boshatisur.

Taksa progresive i varfëroi. Taksa që do të jenë më të ulta do të favorizojnë gjithë biznesin e vogël, gjithë shtresën e mesme por edhe biznesin e vogël, të jemi realistë, ndërsa për qarkun e Dibrës, të thashë jemi qarku më i varfër në republikë. Zoti Basha ka thënë që do ta bëj qark pilot, sepse na ka lënë pi-

lot për së mbrapshti kjo qeveri, duke krijuar probleme jashtëzakonisht të mëdha në ekonominë e familjes dhe në ekonominë e gjithë qarkut tonë.

**Tvb:** Bashkitë kanë afro 1 vit e gjysëm që drejtohen nga një parti e vetme. Ju si e vlerësoni punën e tyre dhe çfarë problemaikash keni konstatuar?

E.I.: Për mendimin tim pas zgjedhjes së 25 prillit do t'i drejtohem SPAK-ut, nga ana jonë. Të gjitha dosjet e tenderave që janë bërë në bashkitë e qarkut Dibër duke filluar nga projekti që nuk janë të mirëfillta e me standarte por elektorale, me preventivat me kosto të larta. Këtu fillon korrupsioni. Që në projekt me paraktimin e fituesit, në zbatimin e punimeve në cilësinë e punimeve. Këto elementë janë të mjaftueshme për t'i dërguar në SPAK. Një shi ka rënë dhe

u përmyt rruga. U përmyt sepse nuk mund të shtrosh asfalt pa bërë punimet nëntokësore. Janë rrugë për t'u tallur, asnjë rrugë nuk ofron minimumin e standartit. Si mund të bësh një rrugë sot më 2021 me 2.5 metër gjërësi?

**Tvb:** Sipas Jush, si ka qenë qeverisja e kryeministrit Rama në këto 8 vite?

E.I.: Ku ka shqiptar sot që nuk është rrënuar nga kjo mazhorancë, më gjej një shqiptar socialist, se komunikojmë përditë me to, por fukarallëku dhe rënia ekonomike, gafa ekonomike që ka bërë ky në 8 vjet i ka rrënuar si socialistët, demokratët si gjithë të tjerët.

**Tvb:** Çfarë mesazhi keni për votuesit e qarkut Dibër?

E.I.: Të më japë votën për PD dhe për mua, Edmond Isaku nr. 4, sepse jam kandidati i vetëm i Bulqizës, që përfaqësoj Bulqizën dhe do ta përfaqësoj denjësisht. Kandidatët e tjerë socialistë nuk kanë se çfarë të japin pasi e kanë bërë baltën deri në grykë. Elektorati nuk ka më çfarë të presë nga ato. Kandidatëve të tjerë me keqardhje po ju them se nuk i favorizon ky kod zgjedhor, ndaj të bëhemi bashkë për fitoren e madhe të Pd dhe koalicionit të djathtë.

(INTERVISTË E KANDIDATIT PËR DEPUTET TË PD, EDMOND ISAKU, DHËNË TV BULQIZA. Bulqizë, më 18.03.2021)





## intervista

INTERVISTË NDËRPERSONALE ME  
KANDIDATIN PËR DEPUTET TË QARKUT  
DIBËR Z. EDMOND ISAKU

# Me Partinë Demokratike më lidhin principet e të djathtës

**Intervistuesi: - Zoti Edmond, dëshiroj si hyrje ta hapim me pyetjen që na shtyn të të njohim më thellë. Përse kandidon për deputet dhe çfarë ju lidh me Partinë demokratike ?**

Kandidoj për deputet për të kontribuar për zhvillimin e demokracisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së shqiptarëve. Personalisht jam i interesuar për zhvillimin e qarkut Dibër. Me Partinë Demokratike më lidhin principet e të djathtës: si liria individuale dhe iniciativa e lirë, përparimi i kombit, Zhvillimi i pronës, Integriteti dhe prestigji i familjes, besimi dhe vlerat e religjionit.

**- Cili je realisht ? Do të ishte mirë të tregoje, thelbin e vërtetë të qënies tënde ?**

Edmond Xheladin Isaku. Jam nga Grezhdani i Dibrës. Punoj në sektorin privat ku drejtoj këto lloj aktivitete: Sipërmarrës tek subjektet minerare "Isaku internacional" dhe "Dema - Patin", Sipërmarrës i medias lokale televizionit Bulqiza, kabllor Bulqiza, gazetës "Bulqiza" si dhe sipërmarrës i hotel Bulqiza. Pra aktivitetin tim e kam të shtrirë në qytetin ku unë kam jetuar e punuar për shumë vite. Jam administrator i shoqatës kombëtare të televizioneve lokale dhe kabllore. Jam i angazhuar në strukturat e PD-së, i zgjedhur aktualisht anëtar i Këshillit Kombëtar.

**- Nëse do të shkruanit çdo gjë që të ka ndodhur deri më tani, beson se njerëzit do të donin ta lexonin ? Cili do të ishte tharmi që do t'i detyronte ta lexonin ?**

Besoj se po të shkruaj rreth përvojës time do të ishte shumë interesante suksesi që kam arritur në iniciativën e lirë, me investime në fushën e kulturs dhe industrisë minerare dhe organizimeve sociale, do të shtynte shumë njerëz për t'i lexuar. Pra, tharmi do të ishte, suksesi që kam arritur unë në rrugën e biznesit dhe ndihmën që kam dhënë me investimet e mia.

**- Çfarë quan ti çmenduri ? A kujton ndonjërrën prej tyre e cila pavarësisht etiketimit, ti vazhdon të duket normale ?**

Çmenduri quaj iniciativën që mora në vitin e parë të fillimit të biznesit me Sipërmarrjen e Tv - Bulqizës. Në atë kohë nuk kisha kapital dhe atë pak përvojë, që kisha vendosa ta shtrijsë në këtë biznes.

**- A ke ndonjë fjalë sekrete që e përdor në momentet e tua të vështira ?**

Besimin tek zoti për mbarëvajtjet e punëve

**- Si do ta përshkruash veten tënde me tre mbiemra ?**

I qetë, i matur, bashkëpunues.

**- Beson se njeh veten mirë ? Si e njeh ?**

E njoh mirë veten, me anë të pozitive dhe ndonjë dobësi që kam në jetë.

**- Mund të tregosh historinë më**



**të bukur të jetës në 10 rreshta ?**

Historia më e bukur e jetës time ka qenë kur më ka lindur goca e me pas dy djemtë. Lindjen e fëmijëve e kam përjetuar si gëzimin më të madh të jetës time. Në fushën e biznesit gjëja më interesante dhe e gëzueshme për mua ka qenë dita kur ka filluar transmetimet Tv Bulqiza. Gjatë ditëve që po punoja për hapjen e këtij biznesi i përjetova me një ankth dhe me shumë pengesa. Kur arrita tek transmetimet vizuale për publikun, ishte një ditë shumë e lumtur dhe e veçantë

**- Po më të vështirën ?**

Një ditë të vështirë kam kaluar në fëmijëri. Në atë kohë pas përfundimit të shkollës tetëvjeçare jepeshin bursa studimi për vazhdimin e shkollës mesme. Mua nuk m'u aprovua për arsye biografike. Kjo ka qenë dita më e trishtuar e jetës sime. U detyrova të vazhdoj gjimnazin në qytetin e Peshkopisë duke ecur çdo ditë nga 5 - 6 orë.

**- Si mund ta përcaktosh brezin tënd, ke besuar tek ai, cilët kanë qënë kushtet që kanë ndikuar në formimin e tij? A mund të quhet brez i humbur ?**

Një brez i rritur në kushte të vështira, mund të quhet brez i humbur sepse punuan dhe nuk gëzojnë as një lloje prone

**- Çfarë nuk duron tek të tjerët dhe si e kapërcen mosdurimin ?**

Nuk duroi mashtrimin dhe pandershmërinë kur jam në marrëdhënie pune. E kapërcej me qetësi e në raste përsëritje vendos për vazhdimin marrëdhënies.

**- Mes njeriut më tërheqës, por dhe më të varfër, njeriut më të pa-**

**sur, por dhe më të shëmtuar, cilin do të zgjidhje?**

Do të zgjidhja njeriun tërheqës dhe të varfër.

**- Cilat janë tre cilësitë që çmon tek një njeri ?**

Ndershmërinë, inteligjencën, përkushtimin

**- Çfarë vendi zë gënjeshtria në jetën tënde ?**

Gënjeshtria s'ka vend në jetën time. Dua të jem i qartë dhe i rejtëpërdrejtë.

**- Cili-a je ti në një bashkëbisedim me një mik ?**

Bashkëbisedues miqësor dhe i sinkertë

**- Çfarë është frika për ty?**

Frika për mua nuk ekziston, më shumë më frikëson mbarëvajtja shëndetsore e familjes. Në këtë botë nuk më frikëson gjë.

**- Cila është fuqia që ju keni ?**

Ndjehem mirë nga ana shëndetësore. Besoj në punët që bëj.

**- A ke modele, apo personazhe në jetën tënde. Nëse do të darkoje me të për çfarë do ta pyesje dhe si do të ishte sjellja juaj ?**

Përpiqem të përvetësoj tipare të modeleve më të mira por pa u mbështetur tek një model i veçantë.

**- Keni një proverb tuajin të preferuar, po për çfarë ju shërben ?**

Kam shumë, por i përdorë sipas kontekstit.

**- Thonë që kur të pëlqen puna që bën, çdo ditë ngjan si të ishte pushim... është e vërtetë ? Si dhe ku i organizon pushimet e tua ideale ?**

Punoj sistematikisht, i motivuar dhe pa sforcime. Pushimet i organizoj me familjen në vendet më të mira

brenda dhe jashtë Shqipërisë.

**- Cilat janë marrëdhëniet tuaja me blerjet ? Po nëse do mund të blije vetëm një gjë, çfarë do të zgjidhnit të blinit ?**

Nuk kam ndonjë gjë që më ka mbetur peng.

**- Po raportet tuaja me gjërat e reja...Nëse do të mund të mësonit diçka të re, cilën do të zgjidhnit ?**

Më intereson teknologjia e re për të qenë në harmoni me zhvillimin e shoqërisë.

**- Ndër të tjera libri është një tru që flet, një mik që pret, një shpirt që fal, një zemër që qan... Çfarë lidhje ke me librat dhe cili është vendi që ka zënë në jetën tënde .**

Më pëlqen libri dhe leximi dhe për këtë shkak kam krijuar edhe gazetën "Bulqiza". I dua njerëzit që shkruajnë.

**- Cila është pjesa e trupit të pëlqen më shumë dhe pse ?**

Fytyra.

**- Bota është një libër, dhe ata që nuk udhetojnë lexojnë vetëm një faqe. Cili është raporti që keni me udhëtimin ?**

Bëj shumë udhëtime për arsye biznesi dhe më jep kënaqësi dhe njohje me realitete të reja.

**- Në cilin vend të botës do të pëlqente të jetonit ?**

Në Shqipëri.

**- Liria ... cila është përballja juaj me të, si ka qënë raporti me lirinë në jetë ?**

Lirinë e vlerësoj në të gjitha dimensionet e saj.

**- Çfarë është vlerësimi shoqëror dhe familjar për ty ? Deri kur do të vazhdojë të ketë vlerë ?**

Vlerësimin shoqëror e kam prioritet. Dashuria e përgjeshme është ajo familjare. Do ketë vlerë gjithmonë për mua.

**- Thuhet që asgjë nuk është perfekte... Çdo ndodhte sikur të ishte ?**

Nuk do kishte motivim drejt përsosmërisë dhe cilësisë së jetës.

**- Në të mirë dhe në të keq, një mik i vërtetë, është gjëja më e mirë në këtë botë, çfarë është një mik-mikëshë për ju ?**

Miqësia për mua ka shumë vlerë dhe kam shumë miq. Ndjem I rrethuar nga miq dhe shokë shumë të mirë që më ndihmojnë dhe më japin kënaqësi.

**- Cila ka qënë detyra më e mërzitshme që të ka takuar të bësh ?**

Më e mërzitshmja ka qënë stërvitja ushtarake ( zbori) në ushtri.

**- Në punë tuaj më të fundit, cilat qenë arritjet më të rëndësishme ?**

Përmirësimi i performancës në biznes.

**- Çfarë projektash apo ide kanë lindur nga ty dhe sa janë realizuar falë teje ?**

Idetë dhe projektet me të cilat kam shfaqur në sipërmarrjet e mia i kam

(Vijon në faqen 10)



# Kontributi i Edmond Isakut për Mediat Televizive Lokale



## MUSTAFA GJINAJ\*

Media është një nga fushat më të bukura të investimit por edhe më të vështira për faktin se kërkon investime serioze dhe se njerëzit e njohin pak këtë fushë.

Mondi është një nga dallëndyshet e para të investimit në median televizive lokale...duke ngritur TV Bulqizën, si një dritare e informacionit dhe fjalës së lirë në atë zonë, ku deri në atë periudhë pjesa dërmuese e zonës në të dy anët e kufirit mbulohej me sinjal nga kanalet Maqedonase.

Bashkë me një grup shokësh vendosen të përhapin rrjetin lokal të televizioneve, si në Kukës, Mat, Lezhë e në të gjithë teritorin. Në këto kushte u krijua dhe Shoqata e Transmetuesve Radiotelevizivë kabllorë-valorë..Rrtl., që si mision dhe qëllim të vetin kishte mbrojtjen dhe zhvillimin e medias lokale, në përputhje me kërkesat e kohës, bashkëpunimin në hartimin e legjislacionit për median dhe mbrojtjen e operatorëve lokalë nga arbitrariteti i segmenteve të shtetit.

Duke parë aftësitë dhe kontributin direkt të Edmond Isakut në këtë drejtim, Shoqata e Transmetuesve Radiotelevizivë kabllorë-valorë, e ka zgjedhur atë prej mëse dy mandatesh kryetar të saj.

Dhe në fakt nga ajo kohë e në vazhdim, vetë Mondit, së bashku me stafin e shoqatës janë kthyer në gardianë të fortë në mbrojtje të interesave të operatorëve privatë.

Janë disa ligje, udhëzime të cilat kanë dalë këto vite në plotësim të legjislacionit mediatikë e veçanërisht për median lokale, ku natyrisht do përmendim këtu disa prej tyre, ku kontributi i shoqatës dhe personalisht i Mondit është evident dhe ka dhënë rezultate, siç është bashkëpunimi në hartimin e ligjit nr 97-2013, për Autoritetin e Mediave Audiovizive dhe hartimin e rregulloreve të brendshme.

Do vlente të trajtojë kontributin personal në përmirësimin e projekt-ligjit për të drejtat e Autorit, ku me argumentet e shoqatës, Grupi Parlamentar i Medias me mirëkuptimin e të dy krahëve politikë e ktheu këtë projekt-ligj për ta ripunuar, dhe në fakt u morën në konsideratë rreth 80% e propozimeve tona.

Zhvillimi i medias në tërësi dhe asaj lokale në veçanti në përputhje me strategjinë e BE-së për dixhitalizimin, ka patur përkrahjen e shoqatës, por kurrësi sipas planit të qeverisë që u paraqit në fillim, sipas atij plani i gjithë investimi i televizioneve lokale prej më shumë se 25 viteve, fshihesh me një të rënë

të lapsit, nuk merrej në konsideratë, shpenzimet e miliona eurove të hedhura deri në këtë kohë në investim.

Duhet thënë se dhe në këtë rast, kontaktet, bisedat, shkresat, takimet me Autoritetin e Medias Audiovizive, deputetë, anëtarë të kabinetit qeveritar, dhe komisionin e medias dhanë njëfarë rezultati pozitiv, jo i pranuar nga ne, por e kanë vënë problemin deri diku në rrugën e zgjidhjes.

Duke patur parasysh Kushtetutën e vendit tonë që çdo shqiptar, kudo që të ndodhet, ka të drejtën e informimit, dhe të jetës si ai qytetari në qytet, është punuar që deri në skajin më të largët të vendit tonë të vejë sinjali i TV.lokale, qoftë valore, qoftë dhe kabllorë. Mondit ka qenë në ballë të përpjekjeve, për të mbrojtur operatorët lokalë dhe nga konkurrenca e pandershme, dhe vendimi i Autoritetit të konkurrencës për të hapur tregun e Medias në Shqipëri ka insistimin dhe kontributin direkt të Mondit.

Shoqata Rrtl nën drejtimin e tij ka bërë përpjekje për të mbrojtur, subjektet nga masa administrative, në gjoba, natyrisht jo shkelësi i ligjeve... por nga veprimet arbitrarë...

Me kontributin dhe nën drejtimin e Mondit sot shoqata është një organizëm i cili vlerësohet nga i

## Me Partinë Demokratike më lidhin principet e të djathtës

(Vijon nga faqja 9)

bërë realitet.

**- Tranzicioni shqiptar është përballje e vlerave të shoqërisë shqiptare apo e politikës së prodhuar nga qeveritë e saj ?**

Politika shqiptare e paaftë për të prodhuar vlera si rezultat i mungesës së përvojës ka zgjatur tranzicionin.

**- Jeta jote përballë politikës... cili është vlerësimi yt për politikën shqiptare ?**

Ka përmirësime, me fitoren e opozitës shpresojmë të integrohemi në BE

**- Çfarë është Shqipëria për ty ?**

Vendi ku duhet të punojmë shumë dhe ta duam shumë.

**- Sa është përputhur profesioni që ke imagjinuar në fëmijëri me profesionin që ke sot ?**

Jam i realizuar brenda dëshirave fëmijërore, me sukseset e arritura në vitet e demokracisë.

**- Sa i lumtur je sot dhe si e përjeton profesionin tënd ?**

Jam përgjithësisht i lumtur dhe i motivuar për

## DIBRA AMANET I BREZAVE

**• Njiherë një gjeneral serb shkon te shtëpia e Elez Isufit në Dibër për t'i ba disa propozime në dam të Shqipnisë. Atdhetari i flakë Elez Isufi i kundërshtoi të gjitha e, tue e përcjellë deri në kufi, ndigjon disa fëmijë shkolle që këndonin kangë shqiptare. – Shihni, zotni, – i tha atëherë plaku i Dibrës gjeneralit serb, – edhe me dashtë unë, plaku, me e tradhëtue Shqipninë, nuk më lanë këta fëmijë**

gjithë organizmat ligjorë shqiptarë ashtu dhe të Autoritetit Medias Audiovizive,

Qeveria, Kuvendi dhe institucione të tjera ndërkombëtare që mbulojnë median në Shqipëri.

Ne jemi krenarë që Edmond Isaku kandidon për deputet, pasi me siguri ai do të jetë garant i të drejtës së operatorëve televizivë lokalë dhe dhe i medias në përgjithësi.

**\*Kordinator i Shoqatës së Transmetuesve Radiotelevizivë kabllorë-valorë.**

punë te reja, në ekipin politik të demokratëve

**- Për ty çfarë do të thotë një jetë perfekte ?**

Punë dhe arritje të reja, përsosmëri profesionale dhe cilësi jete.

**- A mndon se fiton opozita ?**

E garantuar fitorja për programin që ka, i cili pëmban qartë nevojat e shoqërisë dhe të kombit dhe degradimi dhe konsumi keqas i qeverisë ekzistuese. Fitorja do të jetë plebishitare për ndryshim, dhe pjesëmarrja në votime do të jetë biblike.

**- Cilin do quani si politikanin më modern dhe me vizion në Shqipëri ?**

Liderin me edukim politik perëndimor, Lulzim Basha. Është një shembull për politikanët shqiptarë.

**- Sa i vërtetë, keni qenë në këtë intervistë ?**

Krejtësisht i vërtetë dhe i sinqertë në gjërat që kam thënë.

**- Suksese në zgjedhjet e 25 Prillit**

Faleminderit ! Fitore për opozitën dhe për gjithë Shqipërinë !

Intervistoi : Redaksia e gazetës "BULQIZA"



# MESAZHI

Edmond Isaku ka aftësi të spikatura për të vlerësuar pozitivisht idetë që ngrenë më lart emrin e Bulqizës

## PATRIOTIZMI I DITËS SOT ËSHTË TË KTHEJTMË PUSHTETIN NË DORË TË QYTETARËVE

- MË 25 PRILL TË MBËSHTESIM NDRYSHIMIN POLITIK PËR TË SJELL SHPRESËN PËR SHQIPTARËT!
- VOTONI PARTINË DEMOKRATIKE DHE EDMOND ISAKUN QË E PËRFAQËSON BULQIZËN DENJËSISHT!

### BASHKIM LAMI

Edmond Isaku u rrit me ne në Bulqizën tonë të dashtur dhe është zgjedhja e duhur për të na përfaqësuar me dinjitet në parlamentin e ri.

Unë e njoh Edmondin që nga fillimet e demokracisë për bindjet e tij të djathta dhe mbështetës i PD-së. Vlerësoj tek Edmondi respektin që gëzon në komunitet me qëndrimin e tij, ku bashkë me familjen janë shembull në marrëdhënie me bashkëqytetarët, si dje kur punonte specialist në minierë, ashtu edhe sot, që tashmë është nga biznesmenët e suksesshëm të Bulqizës.

Edmondi është njeri vizionar, i orientuar saktë në ekonominë e tregut, që me kurajo filloi biznesin dhe arriti të krijojë TV Bulqizën dhe Firmën "ISAKU", i suksesshëm në ngritjen e tij ekonomike, duke zbatuar ligjet me ndershmëri. Që kur ishte në hapat e para, kishte ide të qarta dhe guxim për të ecur në biznes. Ai ka realizuar spektaklin e "Miss Bulqiza" kur kishte shumë pak para, duke e treguar vehten se e don atë vend të zhvilluar si në Europë. Ai e mban vehten ngushtësisht të lidhur me Bulqizën duke dhënë shembull në orientimin e investimeve të tij me ngritjen në qendër të qytetit të kompleksin bashkëkohor mediatik të TV, hotelit e restorantit, ku shërbehet me cilësi të lartë të akomodimit të turistëve duke i dhënë emër Bulqizës në hartën turistike.

Edmond Isaku është biznesmeni i Bulqizës që ka mbështetur prej vitesh financiarisht projekte kulturore, sportive, mediatike e sociale duke u bërë shembull në dashurinë për këtë vend, ku jeton qysh prej rinisë së tij. Edmondi ka aftësi të spikatura për të vlerësuar pozitivisht idetë që ngrenë më lart emrin e Bulqizës. Ai ka mbështetur botimin e "Gazetës Bulqiza" në bashkëpunim me kryesinë e "Shoqatës Atdhetare Kulturore Bulqiza" dhe hapjen e faqeve në internet [www.gazetabulqiza.al](http://www.gazetabulqiza.al) dhe [tvbulqiza.al](http://tvbulqiza.al), duke bërë të mundur për çdo emigrant, që të njihen me zhvillimet në vendlindjen. Ai është me vizion perëndimor për zhvillimin e Bulqizës dhe bashkëpunues në zbatim të ideve progresiste. Përvoja që ka sot Edmondi dhe arritjet e tij janë faktor i rëndësishëm që ai ta përfaqësojë Bulqizën në parlamentin shqiptar me synime për të ngjallur shpresën tek shqiptarët që ky vend bëhet, në qoftë se luftohen krimi e korrupsioni. Ai është njeriu i duhur që bashkë me kandidatët

e PD-së për deputetë që e njohin këtë komunitet për të gjitha problemet shqetësuese që ka Bulqiza e Dibra, duke i bërë ato objekt debati për t'i futur në rrugën e zgjidhjes e të zhvillimit të kësaj zone që është lënë në harresë nga qeverisja e rilindjes.

Edmond Isaku duke iu bashkuar ekipit vizionar e fitues të kryeministrit të ardhshëm të vendit, z.Lulzim Basha që po shpalos programin real për ekonomi të fortë dhe shtetin në dorë të qytetarëve, do ta vendosë të sigurtë Dibrën dhe gjithë Shqipërinë në rrugën e zhvillimit duke u ndarë përfundimisht nga krimi dhe droga. Unë, biri i Bulqizës, Bashkim Lami e kam dashur dhe e dua vendlindjen time dhe jetoj çdo ditë me shqetësimet



publike, që vijnë nga andej, edhe pse banoj prej vitesh në Tiranë. Mua nuk më kanë munguar iniciativat për rrugën që duhet zgjedhur, por sot ndjej përgjegjësi për thirrjen që u bëj bashkëqytetarëve të mi, të mbështesin në rrugën e

fitores Partinë Demokratike duke votuar në numrin 9, dhe kandidatin Edmond Isaku me numrin 4 në listën e koalicionit opozitar. Kështu do të lindë shpresa e re për të ecur përpara drejt zhvillimit e integritit për Shqipërinë!

## POEZI NGA SURI ZOGU



### HË, BESO PO DESHE

M'gënjeve një herë veten s'e fajsova,  
T'dija burr me vlerë, ndaj unë të besova  
Më gënjeve prapë, ah, ç'ma bërë mirë,  
Se vetë u tregova budalla me brirë  
Ndaj dhe ju, o njerëz, mos besoni shumë  
Se do t'përfundoni budallenj si unë.

### E BUKURA RINI

Je ti, rini, e thjeshtë si thjeshtësia,  
Je e dashur ti si vetë dashuria,  
E ëmbël dhe e bukur si vetë bukuria,  
E vrullshme, shpërthyes si vetë stuhia.

Tek ti ndizet flakë zjarri i dashurisë,  
Ti zgjat përjetësisht dorën e miqësisë.  
Je plot besim në veten tënde e thua:  
"Vetëm unë jetoj, ja shikoni mua!"

Hidhërimi dhe brenga ty të kanë hije,  
E hedh vallen ti me hap nusërie,  
E çan rrugën ti me dorë burrërie,  
E sheh t'ardhmen ti me ndjenjë krenarie.

Në rrugët e jetës edhe pse ndjen dhembje,

Shpresa e besimi janë në mendjen tënde,  
Forca, bukuria të shihen në sy,  
Të ardhmen e ndritur ke përpara ti.

Mos u perbalt në llumin e kësaj bote,  
Shih të ardhmen tënde veç te shpresa jote,  
Dlirësia jote nuk duhet të zhgërryhet,  
Pastërtia jote s'duhet të përlyhet.

Hidhe vallen hidhe, vallen arbërore,  
Me pleq e fëmijë kapur dorë për dore,  
Këndoje me zjarr këngën e lirisë  
Te ushtojë kudo anë e kënd Shqipërisë...

### UJKUN E BËJNË BARI

S'kishte ndodhur kjo çudi,  
Ujkun ta bëjnë bari.  
U mblodh fshati mu te rrapi  
I kish zënë i madhi hall,  
Ish bërë puna lesh arapi  
S'i çonin delet në mal.

Folën gjatë e diskutuan  
Për të gjetur një bari,  
Por asnjëri nuk pranonte  
Të shkonte me bagëti.

U ngrit njeri andej nga fundi:  
Më degjoni, kam një mendim,  
Meqë s'ka bari katundi  
A çojmë ujkun n'vendlindim?

Ju them kështu, mos u çuditni,  
Ujku s'është siç ish më parë,  
Nuk i ha më delet tona  
Është bërë "qinqj" e mjaft i mbarë.

Ujku që rrinte mënjanë,  
Lëpiu buzët me kënaqësi,  
U ngrit menjëherë në këmbë  
Dhe foli me përulësi:

-Ju o njerëz mos u zini,  
Hiç merak ju të mos kini,  
Delet ua ruaj unë,  
Jam i zoti për këtë punë  
Më dëgjoni, o njerëz të mirë,  
Unë një gjë po ju premtoj  
Sa t'jem gjallë e deri sa t'vdes  
Bagëtinë do t'jua mbroj.

E vendosën më në fund  
Ujkun ta bënin bari,  
Ashtu t'lodhur u shpërndanë  
Edhe shkuan në shtëpi.

I kenaqur bari ujku  
Në kullotë delet i çoi,  
Shkuan ditë dhe gjë nuk ndodhi,  
Kjo fshatarët i gezo.

Por një ditë ndodhi kërdua,  
S'erdhen delet në shtëpi,  
Ujku i shtyrë nga babëzia  
T'gjitha delet i kish gri.

O ju njerëz të trullosur,  
Po si more ju lanë mendtë?  
Po pse more të marrosur  
E vutë ujkun t'ruajë dhentë?

E harruat thënien e mençur  
Që në shekuj ka udhëtuar,  
Ujku qimen e ndërron,  
Zakoni s'e ka harruar?



Votoni Partinë Demokratike  
për një Shqipëri të begatë!

VOTO 9



25 PRILLI, FUNDI I PUSHTETIT  
KRIMINAL TË RILINDJES

XHELAL MZIU: Voto për  
rrëzimin e së keqes dhe  
triumfin e së mirës

Voto PD me nr. 9 □ Voto për rrëzimin e së keqes dhe triumfin e së mirës!  
Voto më #25Prill! Voto punësimin, mirëqenien, rritjen e rrogës, pensionit e ndihmën ekonomike. Voto për infrastrukturën e munguar dhe integrimin Evropian!  
**Voto për veten, familjen dhe Shqipërinë.**  
#Dibra Fiton □ #Mati Fiton □ #Bulqiza Fiton  
#Shqipëria FITON



KRESHNIK COLLAKU:  
Dita e ndarjes me të keqen

25 Prill, dita e ndarjes me të keqen, dita e rikthimit të demokracisë në vend, dita e fitores mbi të keqen, e dritës mbi errësirën, dita e shpresës për një të ardhme më të mirë.  
Votoni Partinë Demokratike të Shqipërisë, e cila është partia që punon për njerezit, për rininë dhe gjithë shtresat shoqërore, partinë që do e integrojë vendin në familjen europiane.  
Votoni Nr. 9 votoni të ardhmen tuaj dhe të fëmijëve tuaj!!



DHURATA ÇUPI –TYLI:  
Votoni Partinë Demokratike  
për një Shqipëri të begatë!

Shqipëria do ndryshojë me Partinë Demokratike dhe Lulzim Bashën kryeministër.  
Shqipëria ka nevojë për ndryshim për ta bërë jetën më të mirë - për të hapur vende të reja pune, për t'i dhënë të rinjve tanë një të ardhme më të mirë këtu në Shqipëri. Dhe këtë ndryshim Shqiptarët e dinë se jua sjell vetëm Lulzim Basha. Votoni Partinë Demokratike për një Shqipëri të begatë!



EDMOND ISAKU: DO TË  
PËRFAQËSOJ INTERESAT  
TUAJA NË PARLAMENTIN RI..

Tashmë që gara elektorale ka startuar, dhe mu a m'u dha besimi nga leadershipi demokrat të jem Nr.4 në listën e kandidatëve të PD në qarkun e Dibrës, shpreh bindjen e palëkundur në mbështetjen tuaj, për të maksimalizuar votën për PD-në dhe për të garantuar FITOREN TONË TË MADHE.  
Kam besim të plotë në mbështetjen tuaj dhe të gjithë qytetarëve të Dibrës, Matit, Bulqizës, Maqellarës, Shpenzës e Gjoricës, Ostrenit, Trebishtit e Okshtunit, Zerqanit, Fushë Bulqizës e Martaneshit. Le të punojmë së bashku, shtëpi më shtëpi, familje më familje e me këdo që dëshiron ndryshimin e shumëkërkuar.

